



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202003310/5

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për zbatimin me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit të shtetasve, në ambientet e organeve të Policisë së Shtetit si dhe për garantimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Durrës

Të nderuar!

Sikurse mund të jeni në dijeni përmes korrespondencës tonë zyrtare, Institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur një hetim administrativ në lidhje me rastin e shoqërimit të disa gazetarëve gjatë protestave të organizuara pas vrasjes së shtetasit K.R. Nga materialet dhe njoftimet e administruara nga media e shkruar dhe ajo vizive, rezulton se nga ana e forcave të policisë ka patur disa shoqërime të punonjësve të medias gjatë kryerjes së misionit të tyre të raportimit dhe njoftimit të publikut me ngjarjet aktuale, pavarësisht nga fakti se këta punonjës janë identifikuar menjëherë si të tillë tek forcat e policisë. Konkretisht, mund të përmendim dhe kemi referuar pranë strukturave tuaja rastin e gazetarit të "RTV Ora", Xh.M., Kryeredaktorit të gazetës "Koha Jonë", Q. Xh., rastin e gazetarit të "Syri TV" në Durrës, A. M., si edhe punonjësit të medias "Durrës Lajm", Sh.D..

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit është njohur edhe me disa njoftime që kanë marrë shtetas të ndryshëm në rrjetet e tyre sociale për t'u paraqitur dhe dhënë shpjegimet respektive pranë strukturave të policisë lidhur me pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre publik në protestat e sipërcituara.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese nga ana jonë, kemi kërkuar nga ana juaj¹ një informacion aktual dhe konkret përsa i përket shoqërimit të gazetarëve nga strukturat e policisë, cili kishte qenë shkak dhe baza ligjore e shoqërimit të tyre, cilat ishin aktet dhe dokumentacioni i mbajtur lidhur me këto shoqërime, duke kërkuar të na bashkëngjiten edhe kopje të tyre, nëse kishit dijeni dhe cila ishte arsyeja e komunikimit përmes rrjeteve sociale me shtetas pjesëmarrës në protestat e organizuara, si dhe çdo akt apo informacion tjetër që mund të shërbente në verifikimin dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Në përgjigje të kërkesës tonë, nga ana e Komisarariatit të Policisë Durrës me shkresën me nr. 452/1 prot., datë 22.01.2021, jemi informuar ndër të tjera lidhur me shoqërimin e gazetarit Sh.D., i cili është lënë i lirë menjëherë pas intervistimit nga ana e punonjësve të policisë. Sipas shpjegimit të dhënë nga kjo strukturë, punonjësit e policisë nuk kishin informacion lidhur me profesionin e tij². Ndërkohë që informohemi se nuk ka rezultuar që në Komisariatin e Policisë Durrës të ishte shoqëruar gazetari A. M., pavarësisht se në media është raportuar në mënyrë të ndryshme³.

Gjithashtu në një qëndrim zyrtar të mbajtur paraprakisht nga DVP Tiranë lidhur me këtë çështje⁴, Ju kenë përshkruar disa detaje lidhur me shoqërimin e gazetarit Xh.M.. Gjatë protestës së datës 10.12.2020, pas sulmit me mjete të forta të Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë nga një grup protestuesish, si pasojë brenda ambienteve të këtij komisarati kanë mbetur të dëmtuar dy punonjës të policisë. Shërbimet e policisë kanë reaguar duke ndërhyrë, larguar dhe shoqëruar persona që kanë kryer veprime të dhunshme. Në momentin e shoqërimeve pranë zonës së Kryqëzimit të ish 21 Dhjetorit, punonjësit e policisë i kanë kërkuar këtij shtetasi (Xh. M.), të identifikohet, por ai nuk ka pranuar. Për më tepër, nuk kishte dokument identifikimi dhe jelek identifikues të profesionit të gazetarit me vete, si edhe kishte fyer punonjësit e policisë. Në këto kushte është bërë shoqërimi i tij në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë. Pas kryerjes së veprimeve për verifikimin e tij, kur rezultoi se ishte gazetar, është lënë i lirë dhe ndaj tij nuk janë kryer veprime procedurale apo administrative. Koha e tij e qëndrimit në këtë komisarariat kishte qenë ajo periudhë që nevojitej për identifikimin e plotë të tij, por nga ana juaj nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion verifikues, sqarues dhe plotësues mbi periudhën e mbajtjes së tij në Komisariatin e Policisë nr.2 Tiranë. Vlerësojmë se kjo periudhë mund të ishte e reduktuar në minimum ose brenda një afati të arsyeshëm, aq më tepër kur i referohemi personave apo shtetasve që kanë një impakt apo imazh publik.

Në sqarimet dhe deklaratat e tij publike, gazetari Xh.M. është shprehur se shoqërimi i tij nga kryqëzimi i “21 Dhjetorit” dhe deri në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë ka qenë i dhunshëm dhe nuk janë marrë fare parasysh deklaratimet dhe thëniet e tij se ishte

¹ Shih shkresat tona respektive me nr. K2/I80-2 prot. datë 05.01.2021 dhe K2/I80-3 prot. datë 05.01.2021

² Sipas Raport Shoqërimit nr. 770863, shtetasi Sh. D. është lënë i lirë dy orë pas shoqërimit dhe intervistimit të tij.

³ Shih, për më shumë:

<https://durreslajm.al/aktualitet/dhuna-e-policise-ndaj-gazetarit-mustafa-dhe-shoqerimi-i-montazhierit-te-durreslajm-ugsh>

⁴ Shih shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë me nr. 239/3 prot. datë 26.01.2021.

gazetar dhe nuk po bënte asnjë gjë të kundërligjshme. Ky fakt është pohuar dhe theksuar me forcë edhe në ambientet e brendshme të Komisarariatit të Policisë nr. 2, ku ai pretendon gjithashtu se është goditur me shpullë në faqen e djathtë të fytyrës së tij dhe një efektiv ka fyer rëndë familjen e tij. Po ashtu, atij i është refuzuar edhe kryerja e një telefonate, si një prej të drejtave të tij si person i shoqëruar për të informuar dhe lajmëruar të afërmit apo të njohurit e tij lidhur me shoqërimin me forcë në Komisarariat.

Ky standard ndërkombëtar, është pasqyruar dhe reflektuar edhe në Procedurat Standarde të Punës për Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Në pikën VII/1 gërma “e” parashikohet konkretisht se: *“Personi i shoqëruar ka të drejtë të komunikojë me një person të besuar, avokat apo mbrojtësin ligjor.”*

Nga deklaratimet e tij, rezulton se shoqërimi është bërë vetëm për shkak se po filmonte me celularin e tij personal shoqërimin e disa shtetasve nga punonjës të policisë, pra nuk po kryente asnjë veprim të kundërligjshëm dhe nuk ishte pjesë e lëvizjes së njerëzve që po protestonin në ato momente.

Gjithashtu, janë dhënë të njëjtat sqarime dhe informacione lidhur me shoqërimin e shtetasit Q. Xh., i cili gjithsesi nuk është pasqyruar në regjistrat e personave të shoqëruar dhe nuk figuron i hedhur në sistem si person i shoqëruar. Nga ana e Avokatit të Popullit konstatohet gjithsesi si shkelje e Procedurave të Shoqërimit të shtetasve fakti që një person apo shtetas i shoqëruar nuk pasqyrohet në regjistrat e personave të shoqëruar. Edhe ky shtetas ka qëndruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë, për aq sa është bërë verifikimi dhe identifikimi i tij si gazetar dhe menjëherë është lënë i lirë duke mos kryer asnjë veprim tjetër.

Gjithashtu në përgjigje, Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë shpreh keqardhje, edhe pse në rrethanat e mësipërme, për shoqërimin e dy gazetarëve nga shërbimet e policisë. Për shkak të rrethanave dhe kushteve specifike që u bë shoqërimi ka qenë një lajthitje e justifikuar në subjekt, pasi vetë subjektet nuk mbartnin shenja të dukshme apo dokumente identifikimi.

Ndërkohë në pamjet filmike të publikuara tashmë, konstatohet qartë fakti se Kryeredaktori i Gazetës “Koha Jonë” ka qenë i papërfshirë në protesta dhe vetëm disa metra larg objektit të punës kur është konstatuar dhe marrë me forcë nga disa punonjës civil policie⁵.

Shoqërimi dhe dhuna ndaj kryeredaktorit të gazetës “Koha Jonë”, Q. Xh. nga forcat speciale të Policisë së Shtetit, është dënuar edhe nga Komisioni Europian. Zëdhënësja për çështjet e zgjerimit dhe fqinjësisë së BE-së, Ana Pisonero përmes një qëndrimi për “Euronews Albania”, thekson se kërcënimin dhe intimidimin i gazetarëve është i papranueshëm.

“Paketa e Zgjerimit për 2020 tregon qartazi nevojën për të pasur zero tolerancë ndaj frikësimeve dhe kërcënimeve kundrejt gazetarëve dhe medias në rajon. Është thelbësore që gazetarët në Shqipëri të jenë të aftë ta bëjnë punën e tyre pa qenë të kërcënuar nga

⁵ Shih <https://www.youtube.com/watch?v=jjQWGT2Zzo>

dhuna, sulmet apo intimidimet, për të siguruar që qytetarët kanë akses ndaj informacionit”, thuhet në reagimin e KE.⁶

Qëndrim publik lidhur me përshkallëzimin e situatës në dhjetor 2020, ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic, e cila ndër të tjera është shprehur se: *“Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbytje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstrojnë në mënyrë paqësore dhe të përmbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”⁷*

Gjithashtu, Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se është i shqetësuar në lidhje me ndalimin dhe sulmet e pretenduara ndaj disa gazetarëve që mbulojnë demonstratat.

Sipas znj.Mijatovic, *“sulmet ndaj gazetarëve përbëjnë një shkelje serioze të lirisë së shtypit dhe të drejtës për tu informuar. Autoritetet duhet të sigurojnë që gazetarët mund të vazhdojnë të informojnë qytetarët pa frikë nga kërcënimet ose aktet e dhunës ”.*

Ndërkohë që theksojmë se nuk ka asnjë sqarim shterues mbi procedurën që është ndjekur lidhur me komunikimin me shtetas të ndryshëm përmes rrjeteve sociale. Sipas qëndrimit të DVP Tiranë, Specialistët e Hetimit të Krimeve, kanë marrë informacion në rrugë operative për disa subjekte se duke përdorur median online kanë bërë thirrje për tubime dhe protesta. Duke marrë parasysh se protestat ishin të dhunshme dhe u shoqëruan me thyerje dhe dëmtime të pronës publike/jopublike, këta punonjës kanë komunikuar me këta subjekte për të kryer intervistë me ta për të bërë verifikimet përkatëse.

Nga ana tjetër, në vijim të trajtimit të disa problematikave që kanë buruar nga protestat e muajit dhjetor 2020, në përfundim të hetimeve administrative respektive, institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Së fundmi, jemi njohur edhe me qëndrimin zyrtar ndaj këtyre rekomandimeve, referuar nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën me nr. 1148/2 prot. datë 23.06.2021, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën me nr.4277/1, datë 15.07.2021. Ndër të tjera, në këto përgjigje trajtohen dhe informohemi mbi problematikat që janë konstatuar nga këto struktura pas verifikimit të kryer sa i përket procedurës së shoqërimit të gazetarit Xh.M.. Më konkretisht, informohemi se procedurat e dokumentimit dhe regjistrimit të shoqërimit të shtetasit Xh.M. nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë nuk kanë qenë në përputhje me procedurat Standarde të Punës dhe për këtë shkelje është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor. Nga Drejtoria e Standardeve Profesionale për këtë rast është ndëshkuar me

⁶ Shih <https://www.alb365.al/v1/2020/12/14/ke-dennon-dhunen-ndaj-gazetareve-jo-sulme-dhe-intimidime/?fbclid=IwAR2IC7e3yYkZMWSVOVp95Z7jz5jYYBsmkB10NCEe-JCVv2J4A-vhGBJeiT8>

⁷ Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e datës 16.12.2020 *“Albanian authorities must prevent further police violence and uphold the right to freedom of peaceful assembly”*. <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>

masë disiplinore një punonjës policie. Ndërkohë që nuk është arritur të provohet pretendimi për dhunë fizike ose psikologjike.

Avokati i Popullit vlerëson se dhuna ndaj gazetarëve, fizike apo psikologjike, rrezikon të drejtat për integritet personal, jetën dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Po kështu, mungesa e kujdesit të duhur në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e të gjithë personave apo strukturave që janë përgjegjës, mund të rezultojë në një shkelje shtesë të të drejtave për akses në drejtësi dhe garancitë gjyqësore të të prekurve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Ushtrimi efektiv i këtyre të drejtave përfshin detyrime pozitive dhe negative. Mund të thuhet se, ata që i nënshtrohen juridiksionit të një Shteti mund të kenë të drejtat e tyre themelore të prekura për shkak të veprimeve të agjentëve shtetërorë, ose si rezultat i sjelljes së kryer nga palë të treta, e cila kur nuk hetohet, shkakton përgjegjësinë e Shtetit për shkak të mosrespektimit të detyrimit për të garantuar mbrojtjen gjyqësore. Në rastin e njerëzve që përballen me situata me ndjeshmëri të veçantë, shtetet gjithashtu mund të mbahen përgjegjës kur masat nuk janë ndërmarrë për të parandaluar veprimet që ndikojnë në ushtrimin e këtyre të drejtave.⁸

Sa u përket detyrimeve negative, në zbatim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, shteti është përgjegjës për të gjitha aktet dhe veprimet në të cilat agjentët e saj marrin pjesë në ushtrimin e detyrave të tyre, përfshirë edhe faktin dhe situatën kur tejkalojnë kufijtë e autoritetit të tyre.⁹

Në lidhje me dhunën ndaj gazetarëve dhe personave të tjerë bazuar në ushtrimin e lirisë së shprehjes, Zyra e Raportuesit Special ka theksuar rëndësinë e tre detyrimeve pozitive që burojnë nga të drejtat për jetën, integritetin personal dhe lirinë e shprehjes. Konkretisht, detyrimi për të parandaluar, detyrimi për të mbrojtur dhe detyrimi për të hetuar, provuar dhe ndëshkuar penalisht ata që janë përgjegjës për këto krime.¹⁰ Siç ka treguar Zyra e Raportuesit Special, këto detyrimet janë plotësuese të njëra-tjetrës: në mënyrë që të jetë e lirë, e fortë dhe të ekzistojë debati i pakufizuar demokratik, dhuna ndaj gazetarëve duhet të luftohet përmes një politike gjithëpërfshirëse të parandalimit, mbrojtjes dhe ofrimit të drejtësisë.

Zyra e Raportuesit Special ka theksuar në vijimësi përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë për të mbajtur vazhdimisht qëndrime publike që nuk i vënë gazetarët në rrezik të rritur të dhunës. Zyra e Raportuesit Special ka kujtuar, ndër të tjera, se masa e thjeshtë, por shumë efektive mbrojtëse përbëhet nga qëndrimet e autoriteteve më të larta të shtetit që njohin në mënyrë të qëndrueshme, të qartë, publike dhe të vendosur legjitimitetin dhe vlerën e profesionit të gazetarit, edhe kur informacioni i shpërndarë mund të rezultojë kritik ose i papërshtatshëm për interesat e qeverisë. Në mënyrë të ngjashme, është thelbësore që autoritetet të dënojnë me forcë sulmet e kryera kundër punonjësve të medias dhe

⁸ IACHR. [Report on Citizen Security and Human Rights](#). OEA/Ser.L/V/II Doc. 57. December 31, 2009. Para. 38.

⁹ I/A Court H.R. *Case of the "Mapiripán Massacre" v. Colombia*. Judgment of September 15, 2005. Series C No. 134. Para. 108; I/A Court H.R. *Case of the "Pueblo Bello Massacre" v. Colombia*. Judgment of January 31, 2006. Series C No. 140. Para. 111.

¹⁰ United Nations (UN) Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression, Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Representative on Freedom of the Media, Organization of American States (OAS) Special Rapporteur on Freedom of Expression and African Commission on Human and Peoples' Rights (ACHPR) Special Rapporteur on Freedom of Expression and Access to Information. June 25, 2012. [Joint Declaration on Crimes Against Freedom of Expression](#).

inkurajojnë autoritetet kompetente të veprojnë me rigorozitet dhe shpejtësi për të hetuar ngjarje të tilla dhe për të ndëshkuar përgjegjësit e tyre.¹¹

Sulmet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje veçanërisht serioze të të drejtave të njeriut sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar kështu debatin publik, i cili është në zemër të demokracisë pluraliste. Në përgjigje të nivelit alarmant dhe të papranueshëm të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Evropë, dhe duke pasur parasysh efektin dëmtues në funksionimin e shoqërisë demokratike, në Prill 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin CM / Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.¹²

Rekomandimi është instrumenti i vetëm ndërkombëtar që siguron udhëzime shteruese për shtetet anëtare për të vepruar në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale, promovimit të informacionit, edukimit dhe ngritjes së vetëdijes me synimin për të siguruar mbrojtjen efektive të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe aktorët e medias.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias, jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në një rrezik real dhe të menjëhershëm duhet të kenë qasje të menjëhershme në autoritetet e zbatimit të ligjit dhe/ose në një mekanizëm të veçantë mbrojtjeje/sigurie.

Neni 2 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore mbron të drejtën për jetë dhe përfshin, ndër të tjera, një detyrim pozitiv të autoriteteve për të ndërmarrë hapa për të ruajtur jetën në rast të një rreziku të afërt. Ky detyrim pozitiv nënkupton që shteti duhet të marrë masa parandaluese operationale për të mbrojtur jetën e individëve brenda juridiksionit të tij, kur e di ose duhet ta ketë ditur që ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një individi ose individësh për shkak të veprimeve penale të një pale të tretë.

Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh natyrën specifike dhe vlerën demokratike të rolit të luajtur nga gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias në veçanti kontekste, të tilla si në kohë krize, gjatë periudhave të zgjedhjeve, në demonstrata publike dhe në zona konflikti. Në veçanti, në këto kontekste është e rëndësishme që autoritetet e zbatimit të ligjit të respektojnë rolin e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias që mbulojnë demonstrata dhe ngjarje të tjera. Kartat e shtypit ose sindikata, akreditimi përkatës dhe shenjat gazetareske duhet të pranohen nga autoritetet shtetërore si letra kredenciale, dhe kur nuk është e mundur që gazetarët ose aktorët e tjerë të medias të prodhojnë dokumentacion profesional, autoritetet shtetërore duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të përcaktuar statusin e tyre. Dialogu midis autoriteteve shtetërore dhe organizatave të gazetarëve inkurajohet për më tepër për të shmangur fërkimet ose përplasjet midis policisë dhe anëtarëve të medias.

Në çështjen *Pentikäinen kundër Finlandës*, Gjykata nënvizoi rolin thelbësor të mediave në sigurimin e informacionit mbi trajtimin e demonstratave publike nga autoritetet dhe ndalimin e çrregullimeve. Duke theksuar funksionin “*vëzhgues*” të mediave, gjykata

¹¹ Annual Report 2010. Office of the Special Rapporteur for Freedom of Expression.

¹² Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar në mënyrë të përsëritur që individë, organizata të shoqërisë civile, sinjalizues dhe akademikë, përveç gazetarëve profesionistë dhe medias, të gjithë mund të japin kontribute të vlefshme në debatin publik, duke luajtur kështu një rol të ngjashëm ose ekuivalent me atë të luajtur tradicionalisht nga media e institucionalizuar dhe gazetarët profesionistë.

deklaroi se çdo përpjekje për të hequr gazetarët nga skena e demonstratave duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të rreptë.

Sipas qasjes së Gjykatës, çdo situatë e tillë duhet të shihet në dritën e rrethanave të secilës çështje të veçantë. Elementet që do të merren në konsideratë nga gjykata kombëtare përfshijnë: (a) nëse autoritetet kishin parandaluar ose penguar qëllimisht mediat nga mbulimi i demonstratës/ngjarjes në një përpjekje për të fshehur nga vështrimi publik veprimet e policisë/organeve të tjera publike; (b) nëse bindja ndaj urdhrave të autoriteteve do të kishte penguar plotësisht përfaqësuesit e mediave të kryejnë detyrat e tyre profesionale. Gjykata, megjithatë, gjithashtu deklaroi se gazetarët duhet t'i binden urdhrave të ligjshëm të policisë dhe nuk mund të kërkojnë imunitet nga përgjegjësia penale për arsyen e vetme që vepra penale (nëse ka) ishte kryer gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gazetareske.¹³

Duke pasur parasysh rolin thelbësor të gazetarëve në përcjelljen e informacionit për publikun dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga autoritetet, veçanërisht në kontekste të ndjeshme, është e domosdoshme që autoritetet shtetërore të mos ndërhyjnë në mbulimin nga ana e medias të ngjarjeve që kanë implikime të rëndësishme për funksionimin e sistemeve demokratike. Si rrjedhojë, gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias kanë të drejtë të fotografojnë/demonstrojnë filma, duke përfshirë trajtimin policor të trazirave dhe se pajisjet e tyre nuk duhet të sekuestrohen.

Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të jenë të vëmendshme ndaj shenjave dhe kredencialeve gazetareske. Për më tepër, mungesa e saj nuk duhet të përdoret si pretekst për kufizime të padrejta në aktivitetet gazetareske. Kur gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias nuk janë në gjendje të prodhojnë dokumentacion që tregon statusin e tyre, autoritetet duhet të përpiqen ta verifikojnë atë me mjete të tjera, për shembull, duke konsultuar organizata të besueshme mediatike dhe organizata profesionale të gazetarëve që mund të konfirmojnë statusin e gazetarit. Trajnimi/dialogu i koordinuar midis medias dhe policisë është i rëndësishëm për të kuptuar përgjegjësitë dhe kufizimet e njëri-tjetrit dhe për këtë arsye sigurojnë besim dhe marrëdhënie të mira pune.

Ish-Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut Nils Muiznieks ka theksuar se dhuna e policisë ndaj gazetarëve, veçanërisht kur mbulojnë demonstratat, është ndër kërcënimet më të përhapura ndaj lirisë së medias. Për shembull, në 2013 më shumë se gjysma e të gjitha rasteve të gazetarëve të plagosur përfshinin lëndime të shkaktuara nga policia.¹⁴ Raporti special i Hartësimit të Lirisë së Medias 2018 nga Indeksi i Censurës gjithashtu thekson që anëtarët e forcave të zbatimit të ligjit janë përgjegjës për më shumë se gjysmën e incidenteve kundër medias gjatë protestave të raportuara në shtatë muajt e parë të vitit 2018 në Evropë.¹⁵ Kjo dëshmon qartë një nevojë urgjente për përmirësime në trajtimin policor të mediave që mbulojnë demonstratat.

Në çështjen *Najafli kundër Azerbajxhanit*¹⁶ u trajtua rasti i një gazetari të rrahur nga policia ndërsa mbulonte një demonstratë të paautorizuar. Megjithëse gazetari nuk kishte veshur një jelek blu që e identifikonte atë si anëtar të shtypit, ai kishte veshur një simbol gazetaresk dhe kishte deklaruar vazhdimisht se ishte gazetar. Gjykata jo vetëm që gjeti

¹³ Shif *Pentikäinen v. Finland* (GC), nr. 11882/10, 20 Tetor 2015, §§ 89, 91.

¹⁴ Shih Deklaratën e dhënë nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut Nils Muiznieks në Seminarin mbi mbrojtjen e gazetarëve në KEDNJ në nëntor 2014.

¹⁵ *Demonising the Media: Threats to journalists in Europe*, Index on Censorship, Special report, November 2019, fq 8.

¹⁶ *Najafli v. Azerbaijan*, nr. 2594/07, 2 Tetor 2012.

shkelje të Nenit 3 për shkak të keqtrajtimit, por edhe një shkelje të Nenit 10 të Konventës. Gjykata deklaroi se përdorimi i forcës së tepruar ndaj gazetarëve ndërsa ata ishin duke kryer detyrat e tyre profesionale, seriozisht pengon ushtrimin e tyre të së drejtës për të marrë dhe për të dhënë informacion, pavarësisht nëse kishte ndonjë qëllim nga ana e policisë për të ndërhyrë në aktivitetin gazetaresk.

Vlerësojmë të sjellim në vëmendje se e drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në mjediset e organeve të policisë, rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit, përgjegjësitë e punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar, dokumentimi i shoqërimit në polici dhe rregullat teknike të shoqërimit janë parashikuar në mënyrë shumë të qartë në nenet 6/25¹⁷, 109¹⁸ dhe 122/1¹⁹ të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në

¹⁷ Neni 6 “Përkufizime”, duke saktësuar dhe përkufizuar nocionet dhe termat e përdorur.

¹⁸ Neni 109 “Shoqërimi në polici”

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;

ç) për të parandaluar kryerjen e një vepre penale;

d) kur është larguar pas kryerjes së një vepre penale;

dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;

ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjeneralitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

¹⁹ Neni 122 “Masat mbrojtëse”

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në kreun V “Rastet dhe qëllimet e aplikimit të shoqërimit” të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” parashikohet se:

“Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj, si:

- A. Për identifikimin e personit;*
- B. Si masë mbrojtëse;*
- C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj;*
- D. Sqarimin e një rrethane.”*

Nga përmbajtja e 109, gërma “c” të ligjit nr. 108/2014 dhe të gërmës “D” të Kreut “V” të Procedurës kuptohet se, shoqërimi i një shtetasi duhet të bëhet vetëm nëse ndaj tij ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale. Këto dyshime nënkuptojnë ekzistencën e një apo e disa të dhënave konkrete, e fakteve dhe e rrethaneve objektive, të ndryshme nga supozimet apo hipotezat, sepse ndryshe kalohet në arbitraritet dhe shkelje të rënda të të drejtave të shtetasve.

Mosdisponimi i të dhënave konkrete, e fakteve dhe e rrethaneve objektive nga organi apo punonjësit e policisë, provon plotësisht se shoqërimi i gazetarëve në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 2 apo DVP Tiranë dhe Durrës nuk është bërë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin dhe në procedurën standarde të punës të cituar më lart.

Ndërkohë duhet të theksojmë se në momentin e shoqërimit, këto shtetas kanë ushtruar indirekt detyrën e tyre si gazetarë. Kjo ka sjellë si pasojë edhe pengimin e tyre për të ushtruar profesionin e gazetarit, i cili është i garantuar me ligj. Është rasti t’ju sjellim në vëmendje se këtë shqetësim e kemi trajtuar edhe më parë dhe konkretisht në rekomandimin drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile me shkresën nr. K2/118-4 prot., datë 21.07.2020. Në pikën 3 të tij kemi rekomanduar: *“Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.”*

Përveç sa parashtruam më lart, gjatë shqyrtimit të këtij rasti por dhe nga qëndrimi juaj zyrtar, konstatohet se nga punonjësit e policisë të cilët kanë kryer veprime me të shoqëruarin, nuk kanë përpiluar dhe i kanë dhënë shtetasit Q. Xh. një kopje të procesverbalit për veprimet e kryera me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun VII, pika 1, gërma “f” të Procedurës Standarde të punës, shkelje që është vlerësuar nga ana juaj duke u marrë edhe masa ndëshkuese përkatëse.

Këto shkelje të ligjit nuk cenojnë vetëm të drejtat ligjore të shtetasve të caktuar, por në të njëjtën kohë dëmtojnë imazhin dhe besimin e Policisë së Shtetit në publik.

Ndërkohë është rasti që të sjellim në vëmendje shqetësimin e konstatuar që prej disa vitesh nga Avokati i Popullit lidhur me faktin që oficerët e policisë gjyqësore i kryejnë veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk janë të monitoruara

me kamera për vëzhgimin e veprimeve procedurale të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit në vijimësi i ka rekomanduar organeve të Policisë së Shtetit marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare²⁰, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprimeve të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi më të fortë dhe në vijimësi nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve lidhur me rastet dhe kriteret e shoqërimit në ambientet e policisë në përputhje me aktet normative në fuqi si dhe garantimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për të analizuar rastet, objekt i këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësiave përkatëse, në funksion të një sjellje korrekte të punonjësve të policisë në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

²⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010 [par.18]

- Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vazhdimësi të punonjësve të Policisë për përmirësimin e sjelljes së tyre në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.
- Marrjen e masave të nevojshme për respektimin me rigorozitet të kritereve ligjore gjatë shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit.
- Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtyre rasteve në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e policisë si dhe në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.
- Marrjen e masave për përmirësimin e Procedurës Standarde të Punës për Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për të përcaktuar rregulla të veçanta në lidhje me trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kërkohet të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, si edhe trajtimin e rekomandimit në përputhje me Ligjin,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA